

VENDIM
Nr. 302, datë 28.5.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 775, DATË 24.9.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ADMINISTRIMIN E FINANCIMEVE TË
HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 39, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 26, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 775, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 7, fjalët “... miratuar me vendimin nr. 692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave” hiqen.

2. Në pikën 8, periudha “... 2007–2013 ...” hiqet.

3. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Lista unike e projekteve me rëndësi kombëtare, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përdoret në vijimësi nga Ministria e Financave dhe struktura përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj në negociatat me huadhënësit/dhuruesit për financime të reja, për projektet e investimeve publike, të cilat janë mbi vlerën kufi të përcaktuar me udhëzim nga ministri përgjegjës për financat.”.

4. Në pikën 11, fjalët “... dhe Ministrinë e Integritetit” hiqen.

5. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Ministri i Financave mund të kërkojë e të sigurojë financim nga huadhënësit dhe dhuruesit për projektet e përfshira në listën unike të projekteve me rëndësi kombëtare, të cilat kanë statusin “i maturuar” ose për çdo projekt tjetër, që nuk klasifikohet si projekt me rëndësi strategjike, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të ndryshuar, pas marrjes së kërkesës nga ministria e linjës përfituese, pavarësisht nëse projekti nuk është i përfshirë në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA). Kërkesa paraqitet me kusht që marrëveshja përkatëse financiare të nënshkruhet vetëm pasi të jenë respektuar kushtet e përcaktuara në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Në çdo rast, njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të parashikojnë në programin buxhetor afatmesëm të tyre çdo projekt, për të cilin kanë kërkuar sigurimin e financimit nëpërmjet një huaje ose granti. Kur projekti nuk mund të përfshihet në tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së, ministri i Financave ka të drejtë të pezullojë procedurën për sigurimin e financimit të projektit.”.

6. Në pikën 12 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “b”, fjalia e dytë hiqet;

b) Në shkronjën “d”, fjalët “... të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” ...” zëvendësohen me “... të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ...”.

7. Në pikën 13, pas fjalëve “... marrëveshjet përkatëse të financimit ...” shtohen “... të negociuara dhe ...”.

8. Pika 22 shfuqizohet.

9. Kudo në tekstin e vendimit, emërtesa “Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON) pranë Këshillit të Ministrave” dhe shkurtesa “DEBASKON” zëvendësohen me fjalët “struktura përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj”, sipas kuptimit të fjalisë.

10. Kudo në tekstin e vendimit, fjalët “dhe Ministrinë e Integrimit” dhe “Ministria e Integrimit” hiqen.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës (SASPAC) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku